REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 861/20
Datë/Datum. 29.10.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL -DEÇAN**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr1 i prokurimit	**631-20-1872-2-2-1**
Nr i brendshëm	**631 20 016 221**

Sa i përket tenderit për: **Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"PROing&Partners"SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

K.Diellit, Major M. Bushi Lam. 12/11 Z. e Perëndimit

(Adresa)

Prishtinë — *10 000*

(Vendi) — *(Kodi postar)*

044 269 219 — *N/A*

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Kujtim Zena

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

proing2005@gmail.com

(Adresa elektronike)

29.10.2020

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

PËRGJEGJËSI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR PROing & Partners sh.p.k. PRISHTINË

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës];

Njoftimi për kontratë: 08.05.2020 Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 08.06.2020 Kriteri i për dhënie ka qene tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët. Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 20.10.2020 Kërkesa për rishqyrtim dt:23.10.2020 Vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt. 23.10.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Jemi njoftuar përmes sistemi elektronik e-prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] Jo [ ]

Bashkëngjitur e gjeni vendimin e AK lidhur me refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së; **Neni 7 i LPP-së;** **NENI 13 i LPP-së;** **Neni 59 i LPP-së;** **Neni 61 i LPP-së;** **Neni 62 i LPP-së;** **Neni 64 i LPP-së;** **Neni 39 i RRUOPP-së;** **B-57- Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. **20.10.2020** përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar nga AK me *Letër standarte mbi tenderuesin e Pasukësesëshëm*, ndërkaq është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K.

Ju sqarojmë se ne me dt. 23.06.2020 kemi pasur qasje në dokumente zyrtare për Operatorin Ekonomik AL EGINEERING SHPK. Pas shikimit të dokumentacionit të OE të rekomanduar për kontratë mendojmë që ky operatorë ekonomik është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit pasi që nuk i përmbushin kërkesat e specifikuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

PRETENDIMET ANKIMORE PËR OPERATORIN EKONOMIK **AL ENGINEERING SHPK**

PRETENDIMI ANKIMOR 1

Operatori ekonomik **AL ENGINEERING SHPK** ka prezantuar Certifikatën e Licencës së Projektimit me afat të skaduar.

Ju sqarojmë se në pikën 7.1 & 7.2 Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë është kërkuar:
Kërkesa 5.Operatori ekonomik duhet te ketë licencë te softëerit për projektimin e rrugëve
Dëshmia 5. Kopje e licencës.

Operatori Ekonomik AL ENGINEERING SHPK në hapjen e ofertave ka prezantuar licencën e softuerit me numër: **8987-10644.**
Nëse shohim data kur është licencuar ky operator ekonomik (subscription start) është **29.03.2017** ndërsa data e skadimit të licencës (subscription end) është **28.03.2018**.

Operatori ekonomik AL ENGINEERING SHPK e ka prezantuar licencën e softuerit me validitet të skaduar dhe siç mund të shihen kjo licencë ka qenë valide vetëm deri me datën 28.03.2018, pra data e skadimit është më shumë se 2 vite. Në këtë rast ky OE është dashur të shpallet i papërgjegjshëm sipas nenit 59 paragrafi 4 të LPP-së sepse nuk i ka plotësuar të gjithë kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

PRETENDIMI ANKIMOR 2

Autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik (AL ENGINEERING SHPK), i cili ka ofertuar me çmime abnormalisht të ulëta.

Në vijim është tabela me përllogaritjet e çmimeve:

Nr.	Hartimi-përpilimi i projekteve ideore dhe zbatuese			
	A	B	C	D
1	kushti 1 - është përmbushur kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta	Pranuar 3 oferta		
2	PROing&Partners SH.P.K&FIDAN HASAJ B.I& ARTINGS PROJEKT SH.P.K	1	1.28	Oferta 1
3	AL ENGINEERING SH.P.K	2	0.53	Oferta 2
4	INFRA-PLUS SH.P.K	3	1.58	Oferta 3
5		Totali (1+2+3=6)	3.39	
6		Mesatarja (6/3)	1.13	
7		30% i mesatares (C6*30%)	0.34	
8	kushti 2 - te gjitha ofertat nen ketë çmim përmbushin kushtin e dyte	[illegible]	[illegible]	ne ketë rast vetëm oferta 2 përmbush kushtin e dyte prandaj vazhdohet me kushtin e trete
9		10% ne mes dy ofertave (C2*10%)	0.13	
10	kushti 3 -- pragu 10% ne mes ofertës me te lire ne krahasim me ofertën e dyte me te lire	[illegible]	[illegible]	ne ketë rast oferta 2 përmbush edhe kushtin e trete

Kushti	Kërkesa	Arsyetimi
1	Janë pranuar me shume se 3 oferta	Është plotësuar kushti i pare sepse janë pranuar 3 oferta
2	Çmimi i ofruar është më shumë se **30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve** të përgjegjshëm	Oferta e dyte plotëson kushtin e dyte (30%) sepse çmimi i ofruar është me shume se 30% me i ulet se mesatarja e tenderëve. Shih pragun ne kolonën C8
3	Çmimi i ofruar është më shumë se **10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët**	Oferta e dyte plotëson edhe kushtin e trete (10%) sepse ne krahasim me ofertën e dyte me radhe është me shume se 10% me i ulet. Shih pragun C10
Konkludim		Oferta me nr. rendor 2 plotëson 3 kushtet e përcaktuara dhe si rrjedhoje mund te konsiderohet si oferte abnormalisht e ulet

Nga kjo tabelë shihet qartë që Autoriteti Kontraktues e ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K i cili ka ofertuar me çmime abnormalisht të ulëta, dhe në tabelën në të cilën ne i kemi bërë llogaritjet ashtu siq parashihet tek **Neni 3** tek ***Rregullat për Tenderët Jo-normalisht të Ulët*** janë përmbushur të tri kushtet e parashikuara, prandaj tenderi i OE të rekmanduar për kontratë është tender jo-normalisht i ulët. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues nuk e ka zhvilluar procedurën në pajtim me nenin 3 siç parashihet tek Rregullat për Tenderët Jo-normalisht të Ulët, andaj AK ja në këtë rast nuk e ka marrë për bazë nenin 61 të LPP-së dhe nuk i është përmajtur në detaje Rregullores për Tenderët Jo-normalisht të Ulët.

Në bazë të ofertës të cilën i ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë dhe çmimin total, duke ju referuar rëndësisë së punëve këto çmime janë qesharake dhe të pa arsyetueshme, sepse vetëm shpenzimet për honoraret e inxhinierëve dhe shpenzimet tjera që kanë të bëjnë me këto punë janë më të mëdha se sa oferta e operatorit Ekonomik AL ENGINEERING SH.P.K.

Pra kemi një dallim shumë të lartë mes çmimit të OE të rekomanuar për kontratë dhe ofertuesve tjerë dhe rrjedhimishtë janë plotësuar tre kushtet për zbatim të rregullores për tenderët abnormalisht të ulët.

PRETENDIMI ANKIMOR 3

Në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë tek pika *9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale* është kërkuar:
Kërkesa 6. Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë se Ndërtimit dhe Arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvoje punc profesionale minimum 3 vite.

Per stafin profesioanl duhet te prezentohen

- **Diplomat-kopje të noterizuara (te diplomuarit jashtë vendit diploma te jetë e nostrifikuar ne Kosovë)**
- **Cv-të -të nënshkruara nga Inxhinieri**
- **Referenca ne hartim te projekteve (që e tregojnë përvojen e punës së kërkuar)**
- **Kontrata valide e punës -kopje**

Duke u bazuar në kërkesat e lartshënuara, vërehet se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë në listën e stafit, për kërkesën në lidhje me: **Një Inxhinier i Gjeodezisë ose bachelor i Inxhinierisë se Ndërtimit dhe Arkitekturës drejtimi Gjeodezi me përvoje punc profesionale minimum 3 vite** ka ofruar inxhinierin z. Nevzat Piraj ku nëse shikojmë diplomën e tijë ajo nuk është e përkthyer në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Në këtë rast Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të **Nenit 13 Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik,** konkretisht paragrafi **13.4 i LPP-se** specifikon: *Një operator ekonomik mun ta paraqesë një tender një kërkesë për pjsmarrje apo apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze* .Përkthimi duhet të jetë para datës së hapjes së ofertave, gjë që OE i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar dëshmi që e posedon përkthimin e diplomës para hapjes së ofertave. Madje AK nuk mund te kerkoje informacione sqaruese lidhur me këtë pikë pasi që në nenin 72.2 të LPP-së sqarimet duhet të kërkohen në pajtim me nenet 65-71 të LPP-së, ndërsa në rastin konkret përdorimi i gjuhëve zyrtare bënë pjesë në nenin 13 të LPP-së. Madje në vendimet e mëhershme të OSHP-së vërtetohet një gjë e tillë përshembull vendimi i panelit shqyrtues me numër 60-63/20 ka këtë vendim:

Lidhur me pretendimin e ankuesit se AK-ja, gjate fazës se rivlerësimit, ne kundërshtim me dis
së ka kërkuar sqarim, konkretisht e ka kërkuar nga OE i rekomanduar për kontrate diplomën
njërën nga gjuhet zyrtare. Paneli shqyrtues konform eksperti shqyrtues konstaton se është i që
pretendim i OE ankues për faktin se sipas nenit 72.2 sqarimet duhet te kërkohen ne pajtim me
LPP-së, ndërsa në rastin konkrete përdorimi i gjuhëve zyrtare bën pjese ne nenin 13 të LPP-së.

Po ashtu edhe diploma nuk është prezantuar e noterizuar nga origjinali por vetëm kopje e noterizuar e cila mban datën e noterizimit 24/02/2014 me numër LRP.588/14. Në këtë rast ky operator ekonomik është dashur të eleminohet pasi që nuk e ka plotësuar këtë kërkesë sipas dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Prandaj me këtë dëshmi vërtetohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së, prandaj është dashur të shpallet si OE i papërgjegjshëm konform nenit 59.4 të LPP-së sepse aty shkruan qartë që "*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një*

tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

PRETENDIMI ANKIMOR 4

Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjëshëm pasi që nuk e ka plotësuar siq duhet formularin e tenderit. Në Dosjen e Tenderit konkretisht në pjesën e FDT-së konkretisht në nenin **21.1 Periudha vlefshmërisë së tenderit** është kërkuar validiteti i ofertave në periudhën **60 ditë** ndërsa OE i rekomanduar për kontratë në formularin C e ka validitetin e ofertave në periudhën **90 ditë**, në këtë rast nuk është plotësuar formulari i tenderit siç duhet, ndërsa Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) ne nenin 39 Sqarimi i Tenderit paragrafi 39.8 përshkruan dhe përcakton qartë:

Formulari i tenderit nuk është plotësuar siç duhet- Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm-Kusht administrativ.

Përfundimisht ju si autoritet kontraktues ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e keni bërë konform nenit nenin 59 të LPP-së, ndërsa nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP –së kriteri kryesor për dhënjen e kontatës e që ka qenë tenderi i **përgjegjshëm me çmim më të ulët**.

Duke vepruar në këtë mënyrë, AK-ja njëkohësisht nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së sepse na ka diskriminuar neve edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe është dashur të shpallemi operator ekonomik i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në faktet që u përmendën më lartë autoriteti kontraktues me këto veprime ka rënë në kundërshtim me nenin 1 të LPP-së sepse aty shkruan qartë: *Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.*

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga **OSHP** që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE ***"PROing&Partners"SH.P.K*** si e bazuar
ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM.**
DETYROHET autoriteti kontraktues të bëjë rivlerësimin e ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për